



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
 AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dep. DPKI	Nr. 1767/25
Dep. 06	Data 05.09.2025
Nr. Faq. 06	
Rr. Str.	
Nr. Page.	

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.09.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti DPKI-KIQUQO-0134/25, për zyrtarin e lartë publik z. Arben Mehmeti, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për zyrtarin z. Arben Mehmeti, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit si dhe Rregulloren për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një raportimi me shkrim (KIQUQO-0134/25), me pretendim për konflikt të interesit me rastin e përzgjedhjes së z. Arben Mehmeti si Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje: KPMSHCK), pasi që i njëjti ka votuar për emërimin e tij si kryetar. Tutje, në njoftimin e raportuesit theksohet se, z. Mehmeti vazhdon të punësoj familjarë në këshill si nëpunësin administrativ, dhe dyshohet për lidhje familjare me zyrtaren e pasurisë e punësuar së fundmi në Këshill.

Konform nenit 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit (shkresa zyrtare DPKI-06-907/25).

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, në ambientet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është realizuar një takim me z. Mehmeti, ku janë diskutuar dhe shtjelluar çështjet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ndërsa i njëjti ka paraqitur sqarimet e tij

lidhur me pretendimet e ngritura të cilat sqarime bashkë me dokumentet relevante i ka dorëzuar edhe në formë të shkruar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, përmes shkresës DPKI-06-1081/25.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pretendimet e raportuesit të rastit i ka trajtuar "*prima facie*" në kontekst të ndalesave apo kufizimeve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit, të cilat përcaktohen si situata të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik, ndërlidhur edhe me rregullativën e brendshme të KPMSHCKS-së, përkritazi me zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit.

Fillimisht, lidhur me rastin kemi kërkuar dokumentacion/informata nga KPMSHCK, i cili në përgjigjen e tij ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara nga Agjencia.

Ligji për Parandalimin e Konflikti të Interesit, ka paraparë masat për parandalimin dhe zgjedhjen e konflikti të interesit nga zyrtarët me rastin e ushtrimit të funksionit publik, në kuptim të tërheqjes nga vendimmarrja, diskutimi dhe votimi i çështjes për interes privat për vete apo personat e afërm, duke përjashtuar rastet të cilat shprehimisht janë përcaktuar me ligj. Respektivisht me dispozitën e nenit 19 paragrafi 1.2 është përcaktuar se:

"1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:

[...] 1.2. merr masa për vetëpërjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht me ligj;" [...].

Andaj, në këtë kuptim, sa i përket zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit, me rregullativën e brendshme të Këshillit, respektivisht Rregulloren Nr. 01/2018, për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje: Rregullorja e Punës), është përcaktuar se "*Kandidati për Kryetar të Këshillit, duhet t'i sigurojë së paku dy nënshkrime nga anëtarët e tjerë të Këshillit, të cilat i dërgohen Këshillit për procedim të mëtutjeshëm...*" (paragrafi 2 i nenit 6). Në frymën e kësaj dispozite z. Mehmeti me datën 24.01.2024 ka paraqitur kandidaturën e tij për Kryetar të Këshillit, duke siguruar përkrahjen e katër (4) anëtarëve të këshillit përmes nënshkrimit të tyre.

Si rrjedhojë, sipas Procesverbalit të mbledhjes së tretë (III) të këshillit, të mbajtur me datën 25.1.2025, me pikë të vetme të rendit të ditës 1. *Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*, pa kundër kandidat z. Mehmeti në mënyrë unanime është zgjedhur Kryetar i KPMSHCK-së, për mandat dy vjeçar.

Sipas shkresave të lëndës dhe rregullativës së brendshme ligjore të KPMSHCK, rezulton se përzgjedhja e z. Mehmeti është bërë në pajtim me dispozitat e nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilën përcaktohet se: "*Kryetari i Këshillit zgjidhet me shumicë të votave nga radhët e anëtarëve të Këshillit, me mandat dy (2) vjeçar, dhe me mundësi rizgjedhjeje.*", si dhe nenin 5 paragrafi 2 të

Rregullores së Punës, sipas të cilës *“Kryetari i Këshillit zgjidhet dhe shkarkohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit.”*

Andaj, pjesëmarrja e z. Mehmeti në këtë proces të votimit nuk përbën 'vendimmarrje' në kuptimin e ushtrimit të autoritetit mbi përzgjedhjen, por paraqet realizim të së drejtës së tij për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si e drejtë legjitime që i garantohet me ligj dhe Kushtetutë.

Ndërsa, sa i përket nënshkrimit të Vendimit Nr.463/2024 i datës 25.01.2025, për përzgjedhjen e Kryetarit të Këshillit, nga z. Mehmeti, i njëjti nuk përbën ushtrim të kompetencës vendimmarrëse individuale, (është akt formal që rrjedh nga vendimi i marrë nga këshilli si organ kolegjal), dhe është marrë në përputhje me nenin 13, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-048, i cili përcakton se, *“Kryetari i Këshillit jep autorizime për kryerjen e detyrave, cakton komisione, thërret dhe drejton mbledhjet dhe seancat profesionale të Këshillit, dhe nënshkruan vendimet dhe aktet tjera të Këshillit.”*

Lidhur me pretendimin e raportuesit se, z. Mehmeti vazhdon të punësoj familjarë në Këshill si nëpunësin administrativ, dhe dyshohet për lidhje familjare me zyrtaren e pasurisë e punësuar së fundmi në këshill, Agjencia ka kërkuar informacion nga KPMSHCK, dhe të njëjtit kanë sqaruar se: *“Sa i përket informacionit të kërkuar se “nëse z. Arben Mehmeti dhe V.M. kanë raporte familjare”, ju njoftojë se sipas dokumentacionit që posedojmë nuk kanë asnjë lidhje familjare.”*

Sqarim lidhur me këtë pretendim ka dhënë edhe z. Mehmeti në takimin e mbajtur në Agjenci, sipas të cilit nuk ekziston asnjë lidhje familjare ndërmjet tij dhe zyrtares për të cilën është ngritur pretendimi nga raportuesi i rastit. I njëjti gjatë takimit ka prezantuar dhe deponuar dokumentacionin relevant për rastin, respektivisht Ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile Nr. E... për V.M. sipas të cilit e njëjta është me vendlindje S..., ndërsa sipas Certifikatës së Lindjes Nr. L... të Arben Mehmeti, i njëjti ka si vend lindje L...-P...

Me qëllim të verifikimit të vërtetësisë së pretendimeve të raportuesit dhe palëve të përfshira, Agjencia ka kërkuar (*shkresa zyrtare DPKI-1447/25*) nga KPMSHCK, listën e të gjithë personave të punësuar në Këshill, dhe atë nga data 25.01.2024 (emërimi i z. Mehmeti si kryetar i Këshillit), e deri më datën 23.07.2025. Pastaj, për të konstatuar afërsinë familjare ndërmjet z. Mehmeti dhe zyrtarëve të punësuar në Këshill gjatë kësaj periudhe, Agjencia i është drejtuar me kërkesë Agjencisë së Regjistrimit Civil, e cila përmes shkresës DPKI-1662/25, ka sqaruar se pas verifikimit të Regjistrimit të Gjendjes Civile, përkitazi me z. Arben Mehmeti është identifikuar lidhja familjare vetëm me zyrtarin F.R., respektivisht, prindërit e dy zyrtarëve kanë të njëjtit prindër (nëna e Arben Mehmeti është motra e babait të F.R. - shkalla e katërt e gjinisë së gjakut-vija e tërthortë).

Marrë parasysh faktin se lidhja familjare ndërmjet z. Mehmeti dhe zyrtarit F.R. është në shkallën e katërt të gjinisë së gjakut në vij të drejtë, me qëllim të verifikimit të pjesëmarrjes eventuale në vendimmarrjen të z. Mehmeti në këtë proces, Agjencia ka kërkuar nga KPMSHCK dokumentacionin përkatës përkitazi me procesin e rekrutimit me rastin e punësimit të zyrtarit

F.R., si dhe deklarimin eventual të ushtrimit të ndikimit nga ana e anëtarëve të Komisionit të Pranimit. Sipas shkresave të lëndës (*shkresa zyrtare DPKI-1718/25*), të siguruar nga KPMSHCK-ja, rezulton se:

Më datën 22.02.2024, Sekretari i Përgjithshëm i KPMSHCK, ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës për një (1) pozitë *Nëpunës/e Administrativ/e*, e cila kërkesë është aprovuar nga ana e Kryetarit të KPMSHCK-së z. Mehmeti (Kërkesa: SKMSHCK 1001/2024 e datës 22.02.2024). Si rrjedhojë, me datën 23.02.2024 është shpallur Konkursi SKPMSHCK 1026/2024, për pozitën *Nëpunës/e Administrativ/e*, një (1) pozitë. Më pastaj, me datën 05.03.2024 Sekretari i Përgjithshëm i KPMSHCK, ka nxjerrë Vendimin SKPMSHCK 1278/24, për themelimin e Komisionit të Pranimit lidhur me konkursin si më lartë, me përbërjen F.G. kryesues, B.B. anëtar dhe A.B. anëtar.

Pas skadimit të afatit të konkursit, NJMBNJ e KPMSHCK-së, me datën 11.03.2024 kanë publikuar Njoftimin (Lista e shkurt) e kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën përkatëse (gjithsej dy (2) kandidatë), ndërsa me datën 02.04.2024 është nënshkruar kontrata për marrëdhënien e punës ndërmjet KPMSHCK-së (nënshkruar nga B.B. - NJMBNJ), dhe kandidatit fitues F.R.

Në sqarimet e dhëna nga Sekretari i Përgjithshëm i KPMSHCK-së (*shkresa zyrtare DPKI-1718/25*), është theksuar se: “...për të cilën pozitë në listën e ngushtë kanë qenë dy kandidatë por në intervistë ka marrë pjesë vetëm kandidati F.R.”. Gjithashtu, i njëjti ka sqaruar se: “Lidhur me këtë proces nuk ka pasur asnjë ankesë, dhe jo vetëm gjatë procesit të konkursit por asnjëherë nuk kam pasur asnjë njoftim as nga anëtarët e komisionit të pranimit dhe as nga askush me ndonjë rast të tentimit të ndikimit në vullnetin e tyre”.

Pastaj, referuar zhvillimit të procedurave të rekrutimit në KPMSHCK, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, përmes shkresës zyrtare DPKI-1447/25, ka sqaruar se: “Procedurat e Rekrutimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve njerëzore brenda Sekretariatit të Këshillit të cilat autorizohen nga unë si Sekretar i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Anëtarët e Këshillit nuk kanë asnjë rol në punësimet dhe transferimet e shërbyesve civil. Këto janë përgjegjësi të Sekretariatit të Përgjithshëm dhe Komisioneve të Pranimit ku shpesh here në mungesë personeli – krijojnë komisione me anëtarë të jashtëm.”

Tutje, në sqarimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KPMSHCK-së, theksohet se: “Në kuadër të Këshillit funksionon sekretaria, e cila ndihmon në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të Këshillit. Sekretaria udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm, i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë kryetarit të Këshillit. [...] Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e sistemit të brendshëm administrativ, përfshirë administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore.”

Sqarimet e Sekretarit të Përgjithshëm të KPMSHCK, përkojnë me rregullativën e brendshme ligjore të Këshillit, respektivisht me Rregulloren Nr.01/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe

Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës (tjue: Rregullorja), e cila ka përcaktuar se:

“1. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit përbëhet nga: 1.1 Sekretari i Përgjithshëm; 1.2 Staf i profesional; dhe 1.3 Personeli mbështetës.

2. Sekretari i përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i Këshillit, mandati i të cilit është i njëjtë me mandatin e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues, siç përcaktohet me ligjin përkatës për zyrtarët publikë. [...]

5. Nëpunësit civil profesional dhe mbështetës në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm janë: 5.1 Zyrtari i lartë për burime njerëzore; 5.2 Zyrtari i lartë i prokurimit; 5.3 Zyrtari certifikues; 5.4 Zyrtar i lartë për Komunikim me Publikun; [...].

Referuar dispozitës si më lartë, në kuadër të zyrës së Sekretarit është edhe Zyrtari i lartë për burime njerëzore, i cili zhvillon procedurat e rekrutimit nën hierarkinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, ndërsa kompetencat e Këshillit janë të përcaktuara me Ligjin për KPMSHCK, të cilat nuk kanë të bëjnë me përzgjedhjen apo emërimin e zyrtarëve të Këshillit.¹

Bazuar në sqarimet e deritanishme, pjesëmarrja e z. Mehmeti në procesin e përzgjedhjes së tij si Kryetar i Këshillit si dhe punësimi i V.M. si Zyrtarë për Shpenzime, Pasuri dhe Asete dhe F.R. si Nëpunës Administrativ në KPMSHCK, përkitazi me pretendimin për lidhje familjare me z. Arben Mehmeti, nuk bien ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalim e Konflikt të Interesit.

Kjo për faktin se, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të Ligjit për Parandalime Konflikti të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”,* ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se: *“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalime Konflikti të Interesit, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,* dhe nënparagrafi 1.6, me

¹ Neni 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 06/1 -048 për këshillin e pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës

të cilin është përkufizuar se: “*person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin [...]”.*

Përveç kësaj, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e përkufizon nocionin vendimmarrje si: “*çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.*”

Në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë, pjesëmarrja e zyrtarit në vendimmarrje dhe ekzistimi i interesit privat (çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste) të zyrtarit në atë vendimmarrje, janë kushte kumulative të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t’u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17, lidhur me nenin 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Palët e pakënaqura, kanë të drejtë të inicojnë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Baleshkaj
Drejtore i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit